

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,DEGA NOVOBËRDË,DEPARTAMENTI I PËRGJITHËM**,përmes gjyqtarit të vetëm Hasan Sadiku,me bashkëpunëtorin profesional Sulejman Rexhepi,në lëndën penale kundër të pandehurve,K. I. J. H dhe A. S. që të gjith nga Gjilani, për shkak të veprës penale Posedimii pa autorizuar narkotikëve,substancave psikotropike ose analoge nga, neni 275 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1lidhur me nenin 31 të KPRK-së,duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore,Departamenti për krime të përgjithshme në Gjilan (PTH),PP.II.nr.462/2017,e datës 21.03.2017,dhe kërkesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor, më 25.04.2017,hartoi këtë.

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e P.TH në Gjilan,PP.II.nr.462/2017 e datës.21.03.2017 për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurve:

**K. I. S.**, nga babai dhe nëna , i lindur më 30.10.1995,në Gjilan me vendbanim të përhershëm në ,lagjja” ”pn.,din shkrim lexim, ka të kryer shkollën e mesme,student,i gjendjës së mesme ekonomike,shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës .

**J. H.**, nga babai ,dhe nëna i lindur më në Gjilan me vendbanim të përhershëm në,lagjja “I ”nr. , pa martuar,din shkrim lexim,ka të kryer shkollën e mesme,i gjendjës së mesme ekonomike,shqipëtar ,shtetas i Republikës së Kosovës.

**A. S.** nga babai ,dhe nëna ,i lindur më ,në Gjilan,me vendbanimtë përhershëm në ,lagjja” ”nr. ,i pa martuar,din shkrim lexim,ka të kryer shkollën e mesme,i gjendjës së mesme ekonomike,shqiptar,Shtetas i Republikës së Kosovës .

*Janë fajtor*

Me datën 18.03.2017,rreth orës 23:30 min.,në fsh.,Komuna e Novobërdës gjatë një kontrolli rutinore që është bërë nga Njësia patrulluese e Stacionit të Novobërdës të njëjtit bëjnë kontrollimin e një automjeti të udhëtarëve të markës Mercedes ,me targa të regjistrimit 6-798-CP të cilën e drejtonte shoferi-tani i pandehuri K. I. J. H dhe si pasagjer ishin tani të pandehurit tjerë J. H dhe A. S. si dhe mituri E. G. Gjilani,ndërsa gjatë kontrollimit të bërë të personave dhe automjetit që ishte i ndalur në parking skaj rruge dhe po përgaditej për të u nisur në drejtim të Gjilanit dhe pas kontrollimit të vendit për reth ku ishte i ndalur automjeti,në afërsi të automjetit nga ana e shoferit në largësi prej reth një metër është gjetur një mulli për bluarje me substanca narkotike brenda ,më këtë rast nga njësia DHNT-së të pandehurit shoqërohen në Stacionin e policisë në Gjilan ,ku të njëjtit e pranojnë se substanca narkotike e gjetur ishte e tyre,ndërsa mulliri për bluarje dhe sasia e narkotikut e gjetur brenda në mulli është sekuestruar dhe pas matjes dhe bërjes së testit fushor,ka rezultuar se substanca e gjetur ishte e llojit Marihuanë dhe peshon 1.6 gram,në këtë mënyrë është vërtetuar se të pandehuriti me veprimet e veta ,pa leje dhe autorizim ka poseduar substancë narkotike ,

-me çka në bashkëveprim si bashkëzekutorë kan kryer vepër penale, Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve,substancave psikotropike, ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Andaj,gjykata bazuar në dispozitën e sipërtheksuar ligjor si dhe neneve 4,31,41,46, 73,75.85 dhe 86 e në lidhje me nenin 365 dhe 495 të KPPK-së,të pandehurve i



## G J Y K O N

Me dënim me gjobë secilin në shumë prej nga 250 € (dyqind e pesdhjetë uro), të cilat dënime të pandehurit e lartëcekur do ta arkëtojnë në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merrë formën e prerë.

Nëse të pandehuri refuzojnë që ta arkëtojnë dënimin me gjobë ose nuk janë në gjendje ta arkëtojnë atë, atëherë dënimi me gjobë do të u zëvendësohet me dënim burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Obligohen të pandehurit që ta arkëtoj paushallit gjyqësor, në shumë prej 20 € në afat prej 15 ditësh, nga data kur ky aktgjykim të merrë formën e prerë.

### Arsyetim

PTH-Departamenti për krime të përgjithshme në Gjilan, ka ngritur aktakuzë me kërkesë për urdhër ndëshkimor, PP.II.Nr.462/2017, e datë 21.03.2017 kundër të pandehurve K. I. J. H. dhe A. S. nga Gjilani për shkak të veprës penale Posedimi i pa autorizuari narkotikve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

PTH, pastaj ka paraqitur kërkesën PP.II.Nr.462/2017 e dt.21.03.2017, për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe ka kërkuar që të pandehurit t'i i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë, sipas nenit 493 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata, pasi shqyrtoi, aktakuzën e PTH në Gjilan dhe kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e PTH për dhënjen e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurve dhe t'i u shqiptohet dënimi me gjobë.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura: aktakuza, kërkesa për dhënjen e urdhërit ndëshkimor- dënim me gjobë, kallëzimi penal, nr. i rastit, 2017-DHTN-163 të datës 19.03.2017 të Drejtorisë Rajonale e Policisë-, Drejtoria e Hetimeve të Trafikimit Te Narkotikëve në Gjilan, si dhe raportet dhe deklaratat e oficerëve policor me të njëjtin numër dhe datë si më lartë, deklaratat e të pandehurit, bashkangjitur shkresave të lëndës, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor me bindje se edhe ky dënim i shqiptuar do të ndikoj pozitivisht të pandehurve se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, prandaj e miratoi kërkesën e PTH nga Gjilani dhe të pandehurit i shpalli fajtorë dhe iu shqyrtoi urdhër ndëshkimor, dënimin me gjobë në shumën 250€ (dyqindë e pesdhjetë euro për secilin).

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPRK-së.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Dega në Novobërdë**  
**P.nr.18/2017,më 25.04.2017**

Bashkëpunëtoji Profesional

Sulejman Rexhepi

Gjyqtari,

Hasan Sadiku

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi shprehim të paraqitet kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit kundërshtim këtu dhe në afat të kësaj gjykate.

